



FORÇA JONË

* * * Viti I • Nr. 8 • Nëntor 2012 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Mbahet konferenca rajonale tre palësh: Kosovë-Shqipëri-Maqedoni

Marrëveshje për Përballimin e Situatave të Emergjencave Civile

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës, më 11 dhjetor 2012, ka organizua konferencën rajonale me temë: "Ndërtimi i kapaciteteve rajonale për menaxhimin e krizave". Qëllimi kryesor i konferencës ishte modernizimi i aftësive të menaxhimit të krizave dhe bashkëpunimi rajonal midis Republikës së Shqipërisë, të Kosovës dhe Maqedonisë.

Punimet e konferencës e hapi ministri i FSK-së Agim Çeku, ndërsa në emër të Qeverisë së Kosovës i përshëndeti zëvendëskryeministri i Kosovës Hajredin Kuçi, i cili shprehu mirënjohjen për këtë konferencë, duke e cilësuar të rëndësishëm

arrihet një marrëveshje për ndihmë të ndërsjellë në rast emergjencash. Qëllimi i kësaj qasjeje rajonale është inkorporimi i konceptit "Mbrojtja e zgjuar civile", parim themelor i të cilit është, me investime më të vogla të fitohet më shumë. Kjo nënkupton shmangien e dyfishimeve të forcave dhe burimeve (resurseve) në rajon me krijimin e qendrave rajonale. Ministri Çeku shtoi se një ndër objektivat e Kosovës në përgjithësi dhe të FSK-së në veçanti, është bashkëpunimi rajonal në të gjitha fushat. "Sot jemi mbledhur përfaqësues të Ministrive të Punëve të Brendshme dhe Ministrive të Mbrojtjes të Republikës së

të gjitha kapacitetet, aftësitë si dhe forcat e nevojshme për situatat emergjente. Por është e nevojshme që me një marrëveshje të zhvillohen ato kapacitete të cilat mund t'i jepen në dispozicion edhe vendeve tjera. I tërë ky projekt është duke u zhvilluar me përkrahjen dhe ndihmën e Komandës së Ushtrisë Amerikane në Evropë, duke u nisur nga shembulli i marrëveshjes që kanë gardat kombëtare të shteteve të ndryshme në mes veti, brenda SHBA-ve. Si pjesë e këtij projekti ne me mbështetjen e SHBA-ve jemi duke ndërtuar njësitin rajonal të ekselencës, i cili do ta ketë njësitin rajonal të kërkim-shpëtimit dhe qendrën rajonale të trajnimit për kërkim-shpëtimit. Me këtë rast ministri Çeku falënderoi ndihmën e pakursyer që po japin SHBA-të në ngritjen e kapaciteteve të FSK-së dhe bashkëpunimin e ngushtë me Gardën Kombëtare të Ajovës. Kuptohet se reaguesit e parë në balafaqimin me situatat e jashtëzakonshme janë agjencitë për menaxhimin e emergjencave, dhe vetëm në rast pamundësie të menaxhimit të situatave kërkohet ndihma e ushtrive. Dhe kjo është arsyeja e prezencës së ministrave të Mbrojtjes, për të dëshmuar gatishmërinë për asistencë ushtarake. Konferenca i përmbylli punimet me nënshkrimin e marrëveshjes rajonale, për "Përballimin e Situatave të Emergjencës Civile", të nënshkruar nga ministrat e mbrojtjes dhe ministrat e punëve të brend-



bashkëpunimin rajonal dhe shmangien e krizave. "Qeveria e Kosovës do t'i marrë seriozisht të gjitha rekomandimet që dalin nga kjo konferencë dhe se ky bashkëpunim do të shërbejë si shembull i mirë në procesin e integrimi euroatlantike".

Zv.ambasadorja amerikane në Kosovë, znj. Kelly Degnan, theksoi faktin se, ambasada amerikane inkurajon një nismë të tillë dhe se duhet të jemi të përgatitur për të ndihmuar njerëzit në rast emergjencash. "Kjo konferencë është hapi i parë drejt zhvillimit të qasjes regjionale për t'u përgatitë dhe për të qenë në gjendje që të përgjigjeni së bashku me sektorin e sigurisë në zhvillim të kapaciteteve emergjente". Majori Brian Kreitlow, nga EUCOM-i, e cilësoi si hapin e parë, pas kësaj konference, është zhvillimi i kapaciteteve ndërkom-bëtare. "Ne e përkrahim përgjigjen ndaj krizave, por do të dëshironim që të keni kapacitete të ndërtuara regjionale. Duhet të shikohet fushëveprimi në mënyrë që të përfshihen të gjitha shtetet regjionale si Bosnja dhe Mali i Zi, në baza të rregullta veprimi".

Ne, në këtë konferencë i ftuam të gjitha vendet e rajonit që t'i bashkohen kësaj iniciative tha ministri Agim Çeku, me synim të qartë që të

Shqipërisë, Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Kosovës, për të iniciuar një projekt rajonal për ndihmë në menaxhimin e emergjencave. Në kushtet aktuale ekonomike kur çdo vend ka prioritetet më të larta, asnjë vend vetëm nuk mund t'i përballojë dhe t'i zhvillojë

Qytetarët e Kosovës më së shumti i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë ka publikuar rezultatet paraprake të sondazhit "Barometri kosovar i sigurisë", në vlerësimin e sektorit të sigurisë, të drejtësisë dhe politikës së jashtme. Sipas këtij sondazhi, Forca e Sigurisë së Kosovës ka dalë të jetë më e besueshme. Qytetarët e Kosovës, sipas këtij publikimi më së shumti janë shprehur të kënaqur me punën e Forcës së Sigurisë së Kosovës më 72% , e përcjellë nga KFOR-i më 60% , policia e Kosovës 42% etj. Drejtori i kësaj qendre, Florin Qehaja, ka thënë se programi



"Barometri kosovar i sigurisë" ka për qëllim të bëjë matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me institucionet e sigurisë. Përmes këtij hulumtimi, ne, po iu kontribuojmë proceseve të rëndësishme në vend, ngase konsiderojnë që tashmë ka ardhur koha që fjala e qytetarëve



Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë ta formojnë Ushtrinë e Kosovës

Portali ushtarak amerikan "Stars and Stripes" shkruan se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dëshirojnë të formojnë Ushtrinë e Kosovës, e cila në një afat sa më të shkurtër do t'i bashkohej trupave ushtarake të NATO-s. Gati pesë vjet qysh kur Kosova shpalli pavarësinë, lojtarët e mëdhenj në skenën ndërkom-bëtare e inkurajojnë Kosovën të lëvizë dhe vetëm të bëjë hapa. Njëri nga hapat e parë, siç thotë portali, është krijimi i një ushtrie nga aktualisht 2,500 pjesëtarë, të cilët tani për tani e përbëjnë

Forcën e Sigurisë së Kosovës. Kjo është një detyrë e vështirë për kombin e ri që ende nuk e ka siguruar njohjen e plotë ndërkom-bëtare dhe që gjithnjë kërcënohet nga fqinji i saj verior Serbia, nga e cila shpalli pavarësinë në vitin 2008", shkruan në portalin ushtarak, "Stars and Stripes. Edhe ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku ka deklaruar se në vitin 2013 Kosova do ta ketë ushtrinë e vet, e cila do t'i bashkohet trupave të NATO-s ku bën pjesë edhe Shqipëria.

shme, si dhe drejtorët e qendrave të menaxhimit të krizave.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, në konferencën për media, ministri Çeku deklaroi se FSK-ja është e gatshme të kontribuojë në regjion, ndërsa theksoi se në rastet e katastrofave natyrore mirëpret ndihmën dhe bashkëpunimin e vendeve të rajonit.

Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, Arben Imami përshëndeti Komandën Amerikane për Evropë, për mbështetjen që po jep

në këtë drejtim. Ky është një akt shumë i rëndësishëm i bashkëpunimit konkret, është një shembull shumë i mirë edhe për vende të tjera të rajonit, përfshirë Malin e Zi, Bosnjën, Kroacinë, pse jo edhe Serbinë, në kuadër të A5, për bashkëpunimi rajonal. Në fund ministri Imami tha se më e rëndësishme është se ne, sot, tri vendet tona, vendosëm që të marrim një hap konkret përpara, i cili në radhë të parë do t'iu vlejë qytetarëve në raste të krizave dhe fatkeqësive natyrore.

Ndërsa, ministri i Mbrojtjes i Maqedonisë, Fatmir Besimi tha: "Kjo konferencë është më rëndësi sepse bashkëpunimi i deritashëm në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, sot po merr edhe një vlerë shtesë, gjegjësisht iniciativa për një qasje të përbashkët në kuadër të emergjencave natyrore. Atë çka mund të bëjmë ne është se mund t'i menaxhojmë veprimet tona, me qëllim që t'i minimizojmë humbjet, dëmet dhe në këtë drejtim bashkëpunimi tani më nuk është në pyetje. Modelet që këtu u prezantuan janë më të provuara në botë, si shembulli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe jo rastësisht vije përkrahja e Komandës së SHBA-së, si partner strategjik për të gjitha vendet e rajonit.

Konferenca "Ndërtim i kapaciteteve rajonale për menaxhim të krizave" u mbajt në kuadër të bashkëpunimit trepalësh në fushën e menaxhimit të krizave dhe emergjencave të Maqedonisë, Shqipërisë dhe Kosovës.

të mbizotërojnë në raport me vendimet që merren në nivel qeveritar dhe në nivele të larta ndërkom-bëtare.

Sipas, Armend Mujës nga kjo qendër, publikimi është bazuar në hulumtimin e opinionit publik sipas një sondazhi me anketa. "Është matur kënaqshmëria e qytetarëve me institucionet e sigurisë. Institucioni i sigurisë i cili gëzon kënaqshmërinë më të madhe te popullata është Forca e Sigurisë së Kosovës, ajo pasohet nga KFOR-i. Sipas kësaj ankete, qytetarët e Kosovës më së shumti i besojnë Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Letër urimi i komandantit për pjesëtarët e FSK-së

Kam kënaqësinë e veçantë që në këtë fundvit, në emër të FSK-së dhe në emrin tim, t'ju uroj gjithë pjesëtarëve të FSK-së festat e fundvitit. FSK-ja në këtë fundvit, padyshim se mund të krenohet me të arriturat e saj në të gjitha fushat. Me përkushtimin dhe angazhimin e saj maksimal ka mbajtur lartë motivin dhe ka krijuar një ambient të sigurt për qytetarët e Republikës së Kosovës. FSK-ja ka rritur aftësitë për zbatim jashtë vendit dhe është angazhuar në nismat rajonale, duke treguar se është një forcë profesionale, shumetnike, në shërbim të të gjithë qytetarëve të saj dhe në të mirën e paqes në rajon.

FSK-ja edhe gjatë këtij viti më shumë se kurdoherë ka mirëmbajtur dhe ngritur më tej kapacitetet operuese të saj. Zhvillimi i operacioneve çminuese, operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe atyre humanitare, këtë vit vazhdoi me një ritëm dhe intensitet edhe më të shtuar. Ky vit, ishte vit i rritjes së standardeve tona operuese. FSK-ja ishte edhe më afër qytetarëve, duke iu përgjigjur çdo kërkesë për të intervenuar anekënd vendit, në largimin e mjeteve shpërthyes, kërkimin dhe shpëtimin e banorëve të kërcënuar nga fatkeqësitë e ndryshme. Pjesëtarët e FSK-së këtë vit kanë pastruar me mijëra metra katror nga mjetet e pashpërthyer, duke krijuar një mjedis më të sigurt. Pjesëtarët e FSK-së kanë qenë afër qytetarëve, institucioneve dhe shoqërisë civile, duke i mbështetur në projekte humanitare. Kontributi i FSK-së në rritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë, si ndërtimi i shtëpive, ndihma mjekësore për pjesëtarët e komuniteteve pakicë, ndërtimi i rrugëve, urave, largimi i materieve të rrezikshme, vetëdijesimi i qytetarëve për rreziqet nga mjetet shpërthyes, janë shembujt më të mirë të gatishmërisë sonë për të qenë kurdo dhe kudo në shërbim të qytetarëve.

Ne mund të krenohemi edhe me disiplinën e pjesëtarëve tanë, të cilët kanë treguar motiv të lartë, profesionalizëm dhe integritet, duke qenë të përkushtuar në punë dhe stërvitje. Stërvitja e pjesëtarëve ishte objektiv dhe prioritet gjatë këtij viti. Gatishmëria e tyre për t'u sfiduar në stërvitjet më komplekse dhe për të rritur aftësitë e tyre profesionale, janë për t'u admiruar. Stërvitjet e organizuara dhe të zhvilluara me standardet e përafërta me ato të ushtrive të NATO-s, partnerëve tanë që veprojnë në kuadër të KFOR-it dhe vendeve të NATO-s, të kryera në KDS, qofshin ato indi-



viduale, të udhëheqësve (liderëve) dhe ato kolektive, të kryera dhe nëpër njësi, si dhe ato jashtë vendit, të mbështetura nga KFOR-i, SHBA-të, Mbretëria e Bashkuar, Turqia dhe vendet tjera mike, kanë rritur aftësitë operuese të njësive tona, për çka dua të shpreh falënderimin tim të sinqertë për të gjitha vendet kontribuuese. Ky fundvit na gjen më të stërvitur, më të përkushtuar dhe më të fortë. Na gjen me identitet të përvijuar qartë. Tashmë pjesëtarët tanë identifikohen me shenja dhe uniforma unike. Njësitë tona janë më të kompletuara me pajisje, infrastrukturë dhe me burime, të cilat kanë rritur operueshmërinë dhe kanë bërë që njësitet tona të jenë të gatshme, më të efektshme dhe më afër plotësimit të standardeve të NATO-së. Një e arritur që duhet theksuar është padyshim procesi i standardizimit të dokumentacioneve, pajisjeve dhe mjeteve.

FSK-ja padyshim se mund të krenohet edhe me rritjen e aftësive zbarkuese. Njësitë tona këtë vit zbarkuan disa herë jashtë vendit, për të zhvilluar stërvitje për mbajtjen nën kontroll komunikimin në mes njësive. FSK-ja po shfaqet si një forcë kontribuuese e sigurisë në rajon, dhe e cila po merr pjesë në të gjitha nismat, qoftë në nivel rajonal ose edhe më gjerë. Objektivi ynë për t'u rreshtuar krahe për krahe vendeve anëtare të NATO-s, vendeve aspirantë dhe partnerëve, duke marrë pjesë në ushtrime të përbashkëta, me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në sigurinë rajonale, u provua si kurrë më parë. Këtë vit ishim bashkë me partnerët tanë në konferenca të rëndësishme, si atë të shefave të mbrojtjes të vendeve të A5, konferencat planëzuese të ushtrimeve të përbashkëta etj. Ne po punojmë dhe jemi të gatshëm të bashkëpunojmë për të kontribuar në sigurinë rajonale, duke ngritur njësitin zbarkues të kërkim-shpëtimit dhe ngritjen e një qendre të ekselencës për stërvitje jo vetëm të pjesëtarëve tanë, por edhe të vendeve të rajonit. Për këtë falënderojë veçanërisht SHBA-të, të cilat po japin një kontribut të madh në

ngritjen, stërvitjen dhe pajisjen e këtij njësi.

Ky vit për neve ishte vit i sfidave dhe i përkushtimit, në realizimin sa më kualitativ të misionit dhe objektivave tona. FSK-ja qysh në nëntor të vitit të kaluar i ka përmbyshur kapacitetet operacionale dhe për këtë komandanti i KFOR-it e ka dhënë rekomandimin e tij. Ne nuk jemi ndalur me kaq, gjatë këtij viti kemi rishikuar kapacitete tona operacionale, kriter për kriter, duke e vlerësuar progresin e arritur përmes Raportit Përfundimtar të Progresit, me çka kemi konstatuar një ngritje cilësore në shumë fusha, ku kishim evidentuar mangësi. Kjo e përforcon edhe njëherë gatishmërinë tonë për të marrë përgjegjësi të reja. FSK-ja ka treguar gatishmëri, për të dhënë kontributin e saj në Rishikimin e Sektorit të Sigurisë dhe arkitekturës së re të sigurisë së Kosovës. Shumë ekspertë të FSK-së janë angazhuar nëpër grupe të ndryshme punuese, duke i dhënë cilësi këtij procesi. FSK-ja ka arritur të fillojë procesin e pensionimit të pjesëtarëve të saj, një arritje kjo që ndikon në freskimin dhe plotësimin me kuadro të reja të FSK-së. FSK-ja vazhdon të mbetet e përkushtuar në ruajtjen dhe rritjen e përqindjes së pjesëtarëve të komuniteteve pakicë e veçanërisht të pjesëtarëve të komunitetit serb, duke siguruar kushte të barabarta, si dhe duke organizuar fushata rekrutuese nëpër vendbanimet e tyre.

Sukseset e arritura na bëjnë të krenohemi, na japin besim edhe më të madh në aftësitë tona. Sukseset tona janë fryt i mundit, djersës dhe dijës së të gjithë pjesëtarëve tanë, që me përkushtim dhe profesionalizëm, po iu shërbejnë të gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallim feje, gjinie apo etnie, për çka dua t'i falënderoj edhe një herë përzemërsisht. Sukseset tona janë edhe fryt i përkushtimit të miqve tanë që pandërprerë po na mbështesin, andaj i falënderojmë dhe u jemi mirënjohës. Sfidat që kishim na kanë bërë më të fortë dhe na kanë dhënë edhe më shumë kurajë, për të realizuar misionin tonë të shenjtë. Uroj që viti që po vjen, FSK-në ta gjejë edhe më të përgatitur profesionalisht dhe më afër synimit për të qenë pjesë e nismave të NATO-s, si një kontribuuese e denjë e sigurisë rajonale dhe globale në shërbim të paqes.

Në fund ju uroj shëndet, paqe dhe lumturi, juve dhe familjeve tuaja. Urime!

Komandanti i FSK-së
Gjenerallejtnant Kadri Kastrati

Ministri i Mbrojtjes së Kroacisë vizitoi MFSK-në

Kroacia do ta ndihmojë FSK-në për antërsimin në NATO



Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë të Kosovës, për një vizitë zyrtare, ditëmëparë, ka qëndruar ministri i Mbrojtjes i Ushtrisë së Kroacisë, Ante Kotromanović, i cili u prit me nderime të larta nga Togu i nderit dhe Orkestra frymore e FSK-së. Pas fotografisë së përbashkët, në hollin e Ministrisë, të dy ministrat biseduan kokë më kokë për të vazhduar takimin e përbashkët në nivel të zgjeruar të dy delegacioneve. Në takim mori pjesë edhe zv. ministri Shemi Veseli, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj, gjeneralët: Zymer Halimi, Bashkim Jashari, drejtori i Drejtorisë për Politika dhe Plane, Haxhi Shala, kolonel Ilir Qeriqi, shef i Departamentit për Siguri dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, ndërsa pjesë e delegacionit kroat ishin: Igor Gabriq, këshilltar i Ministrisë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Jerko Letica, këshilltar i ministrit për Politika të Mbrojtjes, Marija Plesha Qadonic shefe e Protokollit, Zoran Drqa shef i Sektorit të Departamentit për Çështje të Sigurisë dhe ambasadori i Kroacisë në Kosovë, Zoran Vodopia.

Të dyja palët, nënshkruan planin dypalësh të bashkëpunimit për vitin 2013.

Ministri i FSK-së, mori mbështetje për bashkëpunim dypalësh (bilateral), mbështetje në rrafshin rajonal, si dhe mbështetje në rrugën e integritit të Kosovës në NATO. Ministri Jeku, me këtë rast tha: "Pata kënaqësinë e veçantë, ta pres ministrinë e Mbrojtjes së Kroacisë, Ante Kotromanović, mikun tim. Me Kroacinë në përgjithësi edhe me zotin Kotromanović na lidhë shumëçka e përbashkët, na lidhë e kaluara, lufta e përbashkët për Kroacinë, por edhe tani na lidh bashkëpunimi për ndërtimin e së



ardhmes.

Me Kroacinë kemi një marrëveshje bashkëpunimi nga e cila ne po përfitojmë shumë, si nga infrastruktura e shkollimit ushtarak, nga përvoja në integrimin në NATO, nga përvoja në operacione paqeruajtëse, nga përvoja për menaxhimin e emergjencave, e sidomos nga përvoja e trajtimit të kategorive të dala nga lufta, ruajtjes dhe kultivimit të vlerave të luftës.

Neve me Kroacinë na lidhë edhe e ardhmja! Do të jemi bashkë në Unionin Evropian, bashkë do të jemi në NATO, bashkë do të jemi në operacione paqeruajtëse një ditë, bashkë do të kontribuojmë në ndërtimin dhe fuqizimin e paqes, stabilitetit dhe bashkëpunimit, këtu në rajonin tonë.

Sipas planit konkret për vitin 2013, pjesëtarët e FSK-së do të mund të shkollohen në 15 shkolla në Kroaci, pastaj në kurse të ndryshme si dhe në pesë fusha të shkëmbimit të përvojave në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë.

Mbështetje morëm edhe në rrafshin rajonal. Kroacia është një fuqi rajonale, lider rajonal në të gjitha fushat dhe Kroacia gjithmonë do të na ketë pranë, në të gjitha iniciativat dhe projektet rajonale në fushën e sigurisë. Mbështetja e tretë është në rrafshin e NATO-s, ku Kroacia si anëtare e NATO-s gjithmonë do ta mbështesë Kosovën, sidomos për agjendën e saj në NATO.

Ndërsa, ministri i Kroacisë, Ante Kotromanović, tha se ne kemi filluar bashkëpunimi midis dy vendeve dhe kjo na e lehtëson vazhdimin e bashkëpunimit. Ne jemi të interesuar që të krijojë një urë të mbrojtjes në mes të dy vendeve, duke bashkëpunuar në fushën e shkollimit, industrisë së mbrojtjes etj. me qëllim që FSK-ja të ngritet në një nivel më të lartë.

Viti 2012 i suksesshëm për FSK-në



Ministri i Forcës së Sigurisë të Kosovës Agim Çeku, sot në ambientet e Ministrisë mbajti një takimim përmblyës me gazetarë, për vitin 2012. Në takim morën pjesë: zëvendësiministri Shemsi Veseli, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, sekretari i përgjithshëm Shkëlzen Sylaj si dhe stafi i lartë i Ministrisë dhe FSK-së. Me këtë rast, ministri Agim Çeku pasi falënderoi mediet, për punën objektive dhe qasjen profesionale, në shkrimet e tyre korrekte për FSK-në si dhe KFOR-in, NATO-n, Gardën Kombëtare të Ajovës dhe partnerët tjerë ndërkombëtarë për bashkëpunimin e mirë me FSK-në, ka vlerësuar realizimin në tërësi të objektivave të ministrisë për vitin 2012, të cilat kanë qenë të parapara në bazë të planit veprues të Ministrisë. Si rezultat i angazhimit të përgjithshëm, ky vit ishte vërtetë vit i suksesshëm për FSK-në, në arritjen e objektivave të cilat ishin: Aprovimi i Kapaciteteve të Përgjithshme Operacionale, nga ana e Këshillit Veri-Atlantik të NATO-s si dhe shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve për kryerjen e misionit kushtetues dhe në ndihmë autoriteteve civile dhe komuniteteve. Vazhdimi i ngritjes dhe ndërtimit i vlerave të identitetit dhe dukshmërisë-vizibilitetit të FSK-së, fuqizimi i bashkëpunimit dypalësh dhe rajonal, bashkëpunimi dhe partneriteti me NATO-n, dhe rishikimi i strukturës, misionit dhe detyrave të MFSK-së në kuadër të RSSS-së.

Gjatë këtij viti kemi bërë përparime të dukshme drejt secilit objektiv, që ia kemi vënë vetes. Si të arriturat-mëtëmaëdha te objektivit i parë, Ministri numëroi: Rishikimi i vazhdueshëm i progresit, krijimi i Qendrës rajonale të kërkim-shpëtimt, themelimi i kompanisë Model, Ngritja e korit të nënoficerëve, trajnime për operacione paqeruajtëse, ushtrimi fushor-Shqiponja 1, ushtrimi për zbarkim jashtë vendit, ushtrimi për komunikim strategjik në këto operacione, si: operacionet e EOD, ku ka pasur 357 intervenime, 36 intervenime të MKAB-së, 33 intervenime në zjarrëfikje, 35 zhbllokime rrugësh, trajnime të ndryshme nga instruktorë vendor dhe nga ata ndërkombëtar; instruktorë nga Ushtria Amerikane, Britania, Turqia, Holanda, etj. Gjatë këtij viti janë avancuar 40 oficerë, 115 nënoficerë dhe janë dekoruar 44 pjesëtarë për arritje të rezultateve të mira; një pjesëtarë, ka mbrojtur doktoraturën, 57 veta kanë mbrojtur magistraturën në lëmi të ndryshme dhe 76 veta kanë kryer Bachelor. Arritja nga objektivit i dytë, është ndërtimi i identitetit kombëtar, ngritja dhe zhvillimi i standardeve dhe vlerave të FSK-së, sipas standardeve të NATO-s. FSK-ja është Forcë aktive dhe e dukshme, ka dhënë asistencë autoriteteve civile dhe mbështetje komuniteteve, asistencë mjekësore, ka marrë pjesë në shënimin e datave të rëndësishme, ka mbajtur ligjëratat për vetëdijësimin nga minat në shkolla, deminimin humanitar, ku kanë pastruar 164.000 metra katror, dhe kanë shkatërruar 771 mjete të pashpërthyer, kultivimi i vlerave dhe identitetit kombëtar, si shënimet e 5,6 dhe 7 Marsit, Dita e Pavarësisë, Dita e Forcës, Uniforma e re, Orkestra frymore, dhe prezantimi i FSK-së jashtë vendit, parakalimi i FSK-së, më 28 Nëntor në Shqipëri, kampi veror në Krivollak, Marshimi në Holandë etj. Te objektivi tre, ministri potencoi bashkëpunimin bilateral dhe rajonal, si dhe nënshkrimin e memorandumeve të bashkëpunimit me Gjermaninë, Letoninë, Kroacinë, etj. Partner programin me Gardën Kombëtare të Ajovës, realizimin e vizitave të autoriteteve të huaja në MFSK-së dhe ato të FSK-së në vende të botës. Ndërsa nga objektivi 4, foli për Bashkëpunimin dhe partneritetin me NATO-n, KFOR-in, etj. Nga Objektivi 5, ministri foli për Rishikimin e SSS-së, "ky proces ka filluar në shkurt dhe është duke ecur sipas dinamikës". Ministri i FSK-së Agim Çeku foli edhe për disa projekte të planifikuara po nuk janë realizuar, me vetë shkakun se nuk kanë qenë prioritet për këtë vit, kanë mbetur të realizohen për vitin e ardhshëm. Ndërsa, për buxhetin për vitin 2012, ministri tha se nga 39.347, 258.00 në total, mbi gjysmën e këtyre mjeteve i kemi shpenzuar për shpenzime kapitale, pastaj për paga dhe shpenzime komunale, etj, dhe në total e kemi realizuar buxhetin, mbi 94 % të aluduar për këtë vit. Ministri Agim Çeku shpalosi edhe prioritet për vitin 2013. Në fund, në pyetjet e gazetarëve për të ardhmen e FSK-së, ministri Çeku ka thënë se pas rishikimit të strategjisë për siguri kombëtare, në qershor të vitit 2013, do të dilet me konkluzat e reja, dhe se viti 2013 do të jetë vit i FSK-së. T'i bashkohet manifestimit gjithëkombëtar për 100-vjetorin e Pavarësisë së Republikës së Shqipërisë.

Kundëradmirali Mark Montgomeri qëndroi për vizitë lamtumirëse në MFSK



Ministri Agim Çeku dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Kadri Kastrati pritën në takime të ndara kundëradmiralin Mark Montgomeri, Patrik Pierci, gjeneralbrigade Steven Daf dhe kolonelin Gjejm Kot. Zëvendës drejtori i Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM), kundëradmirali Mark

Montgomeri falënderoi ministrin dhe komandantin për bashkëpunimin e deritanishëm si dhe konfirmoi bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme për FSK-në edhe në të ardhmen. Admirali Montgomeri i njoftoi ministrin dhe komandantin e FSK-së me kundëradmiralin Patrik Pierci, i cili do ta zëvendësojë atë në detyrë nderitashme.

Montgomeri u shprehur i bindur se marrëdhëniet ndërmjet EUCOM-it dhe MFSK-së do të vazhdojnë në të njëjtin nivel edhe në të ardhmen. Ministri Agim Çeku dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati falënderuan admiralin Montgomeri për angazhimin e tij në drejtim të forcimit të raporteve ndërmjet EUCOM-it dhe FSK-së, për kohën sa ishte në detyrë dhe zëvendës drejtorit të Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë dhe njëherit i shprehen mirëseardhje kundëradmiralit Patrik Pierci, duke i premtuar angazhim në drejtim të thellimit dhe vazhdimit të mëtejshëm të bashkëpunimit. Kjo ishte vizita e fundit e admiralit Montgomeri në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në detyrë dhe zëvendës drejtorit të Politikave, Planeve dhe Strategjive në Komandën Amerikane për Evropë (EUCOM).

Gjenerali Bashkim Jashari priti gjeneralin amerikan Peter Vangjel



Në ambientet e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në Prishtinë, gjeneralbrigade Bashkim Jashari, inspektor gjeneral i FSK-së, ka pritur në një takim pune, inspektorin gjeneral të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, gjenerallejtnant Peter M. Vangjel me bashkëpunëtorë. Gjenerali Bashkim Jashari e ka njoftuar homologun e tij amerikan, për të arriturat e Inspektoratit të FSK-së. Gjatë takimit u bisedua për bashkëpunimin dypalësh ndërmjet dy inspektorateve, të FSK-së dhe Ushtrisë së SHBA-ve, të dala nga memorandumi i bashkëpunimit, u bisedua për rolin, misionin, përballjen e inspektoratit me sfidat e reja, përshtatjen e kapaciteteve dhe funksionet karshi trendeve të reja kudo në botë. Inspektori i Ushtrisë Amerikane, gjenerallejtnant Peter

Vangjel ka premtuar për trajnimin e personelit të inspektoratit të FSK-së, në Shkollën e Inspektorëve të Ushtrisë së SHBA-ve. Gjeneralbrigade Bashkim Jashari ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe gjeneralin Peter Vangjel, për ndihmën e Ushtrisë Amerikane për FSK-në. Inspektori gjeneral i Ushtrisë së SHBA-ve, gjenerallejtnant Peter M. Vangjel së bashku me një delegacion po qëndron në Kosovë, në kuadër të një vizite pune. Në përbërje të delegacionit të Agjencisë së Inspektoratit të SHBA-ve janë zyrtarë më të lartë, përfshi edhe kryeinspektorin e kësaj agjencie, për Ushtrinë e SHBA-ve, në kampin "Bonstill". Në fund, të dy bashkëbiseduesit u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin e dyanshëm në të gjitha nivelet.

Gjeneralmajor Rrahman Rama qëndroi për një vizitë zyrtare në Turqi



Zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Rrahman Rama së bashku me drejtorin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri, kolonel Ilir Qeriqi dhe drejtorin e Departamentit të Personelit, kolonel Skënder Zhitia, bazuar në planin bilateral për bashkëpunim me Ushtrinë e Turqisë, për vitin 2012, kanë vizituar Korpusin e 3-të (Korpusi i 3-të i NATO-s për zbarkime të shpejta) dhe Brigadën e 66 -të Mekanizuar në Stamboll, ku u pritën nga gjenerali Yalçın Ataman, (gjeneral me 4 vje),

komandant i Armatës së Parë të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, nga gjenerallejtnant Kenan Hüsnüoğlu, komandant i Korpusit të 3-të dhe nga Gjeneralbrigade Basak. Delegacioni i FSK-së, është njoftuar me përgatitjet e përgjithshme të Korpusit të 3-të, para zbarkimit. Të dy delegacionet kanë biseduar për shkëmbimin e përvojave dy palësh, në këtë fushë, dhe për mundësinë e përfshirjes së oficerëve të stafit të FSK-së, në kuadër të këtij korpusi.

FSK-ja shënoi Ditën e Forcës në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë

Kuadratet e FSK-së parakalojnë me uniforma të reja



Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, me një manifestim solemn të mbajtur në kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë, kanë shënuar Ditën e FSK-së, shënimi i së cilës këtë vit përko me shënimin jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë.

Ceremonia filloi me inspektimin e

Kosovës, duke iu dalë në ndihmë qytetarëve të vendit pa dallime. Për profesionalizimin e FSK-së dhe ndërtimin e kapaciteteve të saj, si dhe për shkollimin e kaadrove të reja që janë rreshtuar në radhët e saj, e falënderojmë në mënyrë të posaçme NATO-n dhe forcën e saj paqeruajtëse në Kosovë si dhe Gardën Kombëtare amerikane, në veçanti atë të shtetit amerikan të Ajovës (Iowas). Nën mbihëqërijën e tyre Forca e Sigurisë së Kosovës jo vetëm që ka përmbushur priftë, por i ka tejkaluar ato duke u aftësuar, që në një të ardhme të afert të bëhet pjesë e Parteneritetit për Paqe dhe anëtare me të drejtë të plota e NATO-s.

Në ceremoninë e Dites së Forcës së Sigurisë, për bashkëpunimin e mirë me FSK-në dhe për të arriturat e tarave të saj është institucioni më i respektuar i Republikës së Kosovës. Po festojmë suksesin tonë të për-



kuadratet e rreshtuara të FSK-së, nga presidentja Athete Jahjega dhe gjenerallejtënant Kadri Kastrati. I pari që përshëndeti "Ditën e Forcës" ishte kryeministri i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, i cili, tha: "Ndihem krenar që sot jam këtu para jush, në këtë moment kaq të rëndësishëm të historisë së Republikës së Kosovës. Kjo ceremoni është edhe më madhështore, sepse besoj se të gjithë ndajmë së bashku ndjenjën e krenarisë dhe patriotizmit, por edhe të kujtimit për të gjithë ata që na ndihmuan në këtë rrugëtim të gjatë, që dhanë jetën e tyre dhe që janë më mentoret që ne sot jemi këtu.

Sot, po shënojmë Ditën e Forcës me uniforma të reja, që do të jetë simbol identifikues i FSK-së dhe karakterit tonë shtetëror. FSK-ja është përmbushjen e standardeve më të larta të NATO-s, që në një të ardhme të afert të jemi anëtar të NATO-s dhe kontribuues të paqes



Universitare të FSK-së, mbajta e ushtrimit fushor "Shqiponja 1" zburkimi në Krivolak të Maqedonisë, në ushtrimin "Reagimi ndaj krizave"; zburkimi në Danimarkë, në ushtrimin fushor të Njësisë për Reagim ndaj Krizave; zburkimi i kadetëve në Krivolak të Maqedonisë, në një ushtrim të për-

dhe ushtri anëtare të NATO-s; mareshimi tradicional në Nimgen të Holandës; njësitë e qmimit kanë pastruar 701,669 metra katrorë, janë gjetur 2085 mjete të ndryshme eksplozive të pushpërthyer.

Njësi për Eliminimin e Mjeteve të Pushpërthyer (EOD) ka intervenuar në 337 raste, ku ka shkatërruar 402 mjete të ndryshme eksplozive.

bashkët me shumë shtete të rajonit ushtrimit fushor "Shqiponja 1" zburkimi në Krivolak të Maqedonisë, në ushtrimin "Reagimi ndaj krizave"; zburkimi në Danimarkë, në ushtrimin fushor të Njësisë për Reagim ndaj Krizave; zburkimi i kadetëve në Krivolak të Maqedonisë, në një ushtrim të për-

bashkët me shumë shtete të rajonit



sportive, ndërtimi i urave, shtëpipe të banimit, ndihma mjekësore për banorë të komuniteteve jo shqiptare.

Sipas vlerësimeve të përbashkëta të KFOR-it dhe FSK-së, ne i kemi arritur kapacitetet e plota operacionale (KPO). Në nëntor të viti 2011, KOMKFOR-i sipas zinxhrit të vet komandues ka raportuar në NATO, se FSK-ja ka realizuar pesë (5) objektiva dhe 132 kritere të parashtruar, si kritere matëse që FSK-ja të jetë operacionale.

FSK-ja sot ka strukturë funksionale për përmbushjen e misionit që ka. Ajo mund të kryejë të gjitha detyrat që i caktohen. Ne jemi shumë optimist për të ardhmen e FSK-së, si dhe për pozitën e saj në raportet me mekanizmat e NATO-s. Përsim që Këshilli Veri - Atlantik i NATO-s të del me Deklaratë Politike për deklaratimin e Kapaciteteve të Plota

deklaratimin e Kapaciteteve të Plota



him të përvojave. Bashkëpunimi me KFOR-in ka vazhduar me kontakte të rregullta dhe me Ekipin Këshillues Usharak në FSK.

Ky bashkëpunim i thelluar me të drejtë është vlerësuar si bashkëpunim i drejtpërdrejtë me NATO-n. Kemi pasur takime me karakter ndërkombëtar dhe vizita pune të shpeshme të shtabëve të

posaçme dhe e specializuar) e Kërkim-Shpëtim, si njësi e intervenimit operativ jashtë vendit.

Në avancim të këtij projekti po ashtu përfshihen edhe Qendren Regionale Trajnuese të Kërkim-Shpëtim, Kjo qendër ka karakter regional dhe është ngjitur me ndihmen e SHBA-ve.

Zhvillimi dhe ngritja e strukturës së FSK-së është duke u bërë me standarde të NATO-s, që mundëson bashkëpunimin edhe më të mirë me vendet e rajonit dhe vendet që janë anëtare të NATO-s. Kjo ngritje është rezultat i punës së përbashkët dhe ndihmës së pakursyer të partnerëve ndërkombëtarë. Edhe gjatë këtij viti FSK-ja ka pasur ndihmën e vendeve mike, qoftë me donacione të ndryshme, si: mjete dhe teknikë, por edhe me dua të falënderoj të gjitha vendet dhe ushtritë, që ndihmuan FSK-në në çdo aspekt.

Për arritje të jashtëzakonshme u dekoruan ushtarë, nënoficer dhe oficerë, nga presidentja, ministri dhe komandanti i FSK-së.

Operacionale dhe raportin e ardhshëm në mes Kosovës, NATO-s dhe KFOR-it. Perspektiva zhvillimore e FSK-së, do të trajtohet gjatë procesit të Rishikimit të Sektorit të Strategjisë së Sigurisë të Kosovës, në bashkëpunim me partnerët relevant ndërkombëtarë.

Një vend të posaçëm zë bashkëpunimi me Gardën Kombëtare të Ajovës nga SHBA-të, që po jep ndihmë të pakursyer në trajnim të përbashkët me ushtritë e vendeve mike në këm-



Në Ditën e Forcës jepen medalje për kontribut dhënë FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës, dekoron komandantin e FSK-së

Presidentja e Republikës së Kosovës Atifete Jahjaga, në bazë të nenit 84 pika 28 të Kushtetutës së Kosovës, të nenit 7, të Ligjit për Dhënien e Dekorativave, si dhe në bazë të neneve 3,4 dhe 12 të Rregullores mbi Dekoratat, Urdhrat dhe Titujt e Nderit, merr këtë vendim:

Për dekorimin e komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati me Medaljen Presidenciale të Meritave, për pjesëmarrjen në luftë dhe përkushtimin e tij për ngritjen, ndërtimin dhe zhvillimin e TMK-së dhe FSK-së. Medalja Presidenciale e Meritave u jepet personave që me punën e tyre kanë kontribuar në fusha të veçanta si: arsim, shkencë, kulturë, rini, sport, siguri, shërbim civil.

Ministri Agim Çeku ka dekoruar me medaljen për "Shërbim Meritor" kundëradmiralin Mark Mongomeri

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës Agim Çeku duke u bazuar në nenin 3.1 të Ligjit, nr. 03/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, si dhe bazuar në nenin 24 paragrafi 2 të Rregullores nr. 03/2010 mbi Shpërblimet dhe Dekoratat e FSK-së, nxjerr këtë vendim:

Me medaljen për "Shërbim Meritor", ka dekoruar kundëradmiralin Mark Mongomeri.

Medalja i jepet në shenjë falënderimi për kontributin e Tij të veçantë dhe për krahejen e pakursyer për



Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe FSK-në.

Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës duke marrë parasysh nenet 4,21,22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82,21 tetor 2010, si dhe duke u bazuar në nenin 3.1 të Ligjit nr. 03/L-045 për Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcës 5 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive

(22.03.2011), po ashtu bazuar në Rregulloren nr. 03/2010 mbi Shpërblimet dhe Dekoratat për Forcën e Sigurisë së Kosovës, nxjerr këtë vendim:

Me medalje për "Shërbim të Shquar" për përkushtim dhe kontribut në ngritjen dhe zhvillimin e MFSK-së dhe FSK-së dekorohen: Gjenerallejtënant Kadri Kastrati, Shkëlzen Syla-sekretari i përgjithshëm, gjeneralmajor Rrahman Rama-KOMFT, gjeneral brigade Bashkim Jashari-inspektor gjeneral i FSK-së, gjeneral brigade Zymer Halimi DO/MFSK dhe gjeneral



eral brigade Nazmi Brahimaj-KOM-BRSH

Ndërsa me medalje për "Shërbim Meritor" për përkushtim dhe performancë meritorë në detyrë, dekorohen: nënkolonel Agim Vrellaku-inspektor i FSK-së, major Remzije Morina-DPP/MFSK, major Sabedin Zejnullahu -KFT, kapter Lirim Hamiti-komandant kompanie dhe rreshter Shemsije Islami-DO/MFSK

Komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati jep urdhër për dhënie të medaljeve

Në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-082 për Shërbim në FSK, mbi Dekorimet, Shpërblimet dhe Lavdërimet; si dhe nenit 22 dhe nenit 24, pika 3, të Rregullores nr. 03/2012 "Mbi Shpërblimet dhe Dekoratat për Forcën e Sigurisë së Kosovës, me rastin e shënimit të "Ditës së Forcës më-27 Nëntor", komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, jep medaljen "Arripte e Dalluar" me motivacion performancë të dalluar gjatë detyrës,

për pjesëtarët: gjeneral brigade Gëzim Hazrolli, nënkolonel Bajram Uka, toger Fatmir Kajtazi, rreshter Urin Gjoshi, rreshter Xhevdet Zymeri, rreshter Lulzim Rama, rreshter Xhevat Rama, rreshter Afrim Shala, tetar Burhan Daci, tetar Xhevdet Mustafa, tetar Agron Murati, tetar Mentor Jetullahu dhe tetar Xhelal Durmishi, ndërsa me medaljen "E ardhmja fillon këtu" me motivacionin kryerjen e demonstrimeve të shkëlqyera në program akademike dhe trajnuese, për pjesëtarët: major Berat Shala, kapiten Tomë Lleshi, rreshter Shera Kulla-Murati dhe Rreshter Naim Bahtiri, me medalje "Qitës i Dalluar" me motivacion kualifikimi në nivelin e ekspertit të armëve, për kapiten Ramiz Bytyqi, me medaljen "Shërbim" me motivacion shërbim dhe sjellje të ndershme gjatë tri viteve të shërbimit, për pjesëtarët: nënkolonel Fadil Hadërgjonaj, nënkolonel Haki Hoti, major Arife Halili, kapiten Bujar Istogu, rreshter-major Leonora Nimani, kapter Hiser Muja, rreshter Fitnete Sefa, rreshter Shpresa Gashi dhe tetar Daut Ahmeti. Urdhri hyn në fuqi, më 26 nëntor 2012.

Intervistë me oficerin kanadez Wayne Gauthier, këshilltar i Ekipit Këshillues të NATO-s, për FSK-në

Dhurata për fëmijët e Qendrës së Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijëve Në Prishtinë

Forca Jonë: Sa është e gjatë tradita e dhuratave për Krishtlindje, për fëmijët në jetimore?

Wayne Gauthier: Në vitet e kaluara; amerikanët, kanadezët dhe gjermanët e kanë filluar një traditë për festimin e Krishtlindjes në Qendrën e Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës, në Prishtinë. Ne vetëm po e vazhdojmë këtë traditë. Edhe sivjet do të bëjmë një organizim të tillë, ku për nder të kësaj feste do të shpërndajmë dhurata.

Forca Jonë: Kujt do t'i dhuronit dhuratat këtë vit?

Wayne Gauthier: Edhe këtë vit dhuratat do t'ia japim Qendrës së Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës, ku për çdo vit më datën 22 dhjetor organizohet festa e Krishtlindjes. Me këtë rast, secilit prej fëmijëve ua japim dhuratën e

vet. Në këtë mënyrë "Babadimri" sigurohet që asnjë fëmijë të mos mbetet pa dhurata.

Forca Jonë: Në Kanada, festa e Krishtlindjes është e veçantë, çka mund të na thoni për këtë?

Wayne Gauthier; Në kulturën tonë, Krishtlindja është festë shumë e veçantë, posaçërisht për fëmijët të cilëve u japim dhurata. Meqë gjatë kësaj feste ne nuk jemi në shtëpi me fëmijët tanë, atëherë e shfrytëzojmë mundësinë për t'ju dhënë dhurata fëmijëve tjerë, duke i bërë kështu të lumtur në këtë fundviti.

Forca Jonë: A mund të na thoni diçka për mënyrën e shpërndarjes së dhuratave?

Wayne Gauthier: Drejtoresha e Qendrës i ka identifikuar rreth 40 fëmijë dhe gjërat për të cilat ata kanë më së shumti nevojë, e



që zakonisht janë xhaketa, këpucë, triko e të tjera. Në kuzhinën e KFOR-it, në pemën e Krishtlindjes, përveç zburimeve tjera janë të vendosura edhe 40 kartolina me engjëj,

një engjëll për secilin fëmijë, ku është i shkruar emri i fëmijës, moshë dhe çfarë dëshiron fëmija. Pastaj ne e marrim një kartolinë, e blejmë atë dhuratë të cilën e dëshiron fëmija dhe e mbështjellim me letër dekorative.

lim me letër dekorative.

Forca Jonë: Kush do të marrë pjesë në shpërndarjen e dhuratave nga përfaqësuesit e KFOR-it?

Wayne Gauthier: Organizimi i dhënies së dhuratave për festën e Krishtlindjes bëhet nga kontingjenti amerikan, kanadez dhe ai gjerman, të cilët punojnë së bashku për ta mbështetur Qendrën e Përkujdesjes së Nënës dhe Fëmijës. Zakonisht, amerikanët dhe gjermanët i mbulojnë shpenzimet ditore të qendrës, ndërsa kanadezët ndihmojnë në raste të veçanta.

Në fund, zotëri oficer ju falënderojmë për këtë gjest vërtetë human dhe njerëzor, që po bëni me rastin e festës së Krishtlindjes dhe iu urojmë edhe juve Krishtlindjen!

Intervistë me major Remzije Morina, pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës

14 vjet me uniformë ushtarake

"Uniforma e ushtarakut ka qenë shoqëruesi im më i mirë, si në kohën e luftës po ashtu edhe në kohën e paqes. Nuk do ta ndërroja këtë profesion për asgjë tjetër në botë, sepse ky është profesioni më adekuat dhe që secilin ushtarak e bën të ndjehet krenar që i shërben vendit në mënyra dhe qëllime të ndryshme për t'i realizuar synimet dhe obligimet shtetërore"

Major Remzije Morina nga Qikatova e Drenasit është pjesëtare e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e cila tani punon si oficerë për Plane dhe Programe të Buxhetit në Departamentin e Financave, në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ajo ka 14 vite përvojë ushtarake dhe po t'i jepej mundësia të zgjedhë edhe njëherë profesionin e saj, ajo asnjëherë nuk do ta ndryshonte mendimin se profesioni i ushtarakut është ai që i përgjigjet plotësisht.

"Nuk e kam të vështirë jetën ushtarake, duke pasur parasysh që ushtarakët në çdo vend demokratik kryesojnë listat e preferencave publike për demonstrim të tipareve si; nderi, përkushtimi, profesionalizmi, fisnikëria, ndjenja e detyrës etj" u shpreh major Morina.

Major Morina për herë të parë kishte veshur uniformën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në korrik të vitit 1998, ku ishte inkuadruar në radhët e UÇK-së, në Zonën Operative të



Drenicës, përkatësisht në Brigadën 114 "Fehmi Lladrovci", në Dritan (ish Dobroshec).

"Meqë Kosova ishte në një gjendje lufte, mua ndërjegjia më dha urdhër për mobilizim në UÇK. Njëherësh kjo është edhe periudha më e lumtur në historinë e jetës sime dhe nuk do ta ndërroja me asnjë pasuri tjetër në botë. Më të vërtetë ka qenë nder dhe kënaqësi për mua që isha pjesë e kësaj ushtrie, e cila i tregoi adresën e saktë për rrugën e lirisë popullit shqiptar". Gjatë kësaj periudhe i kishin propozuar të punonte si kontabiliste në nivel të brigadës, por e kishte refuzuar sepse nuk dëshironte detyrë tjetër përveç të ushtares. Në mars të vitit 2000 fillon punën në Shtabin e

Përgjithshëm të TMK-së, në Departamentin e Komunikimit. Pastaj pas një viti kalon në Departamentin e Inspektoratit. Ndërsa në vitin 2003, pas disa ristrukturimeve në Shtabin e Përgjithshëm të TMK-së, meqë ishte ekonomiste e diplomuar emërohet me detyrë si oficerë e Buxhetit në Departamentin e Financave, ku edhe gradohet me gradën e Majorit. Gjatë kësaj kohe ajo ka përfunduar trajnime nga fusha të ndryshme si: në atë të auditimit, menaxhimit të financave publike, menaxhimit të projekteve etj. Major Remzije Morina është njëra nga oficerët të cilës iu nda mirënjohja për "Shërbim të Mëritur" më 26 Nëntor në Ditën e Forcës.

"Shpërblimi për punën e mirë është motiv për të bërë më shumë. Edhe në rrethana normale kur merr një dhuratë ndihesh mirë. Marrja e medaljes për "Shërbim Meritor" për mua është edhe më madhështore, meqenëse vjen në vitin jubilar që përkon me 100-vjetorin e shpalljes së Republikës së Shqipërisë, dhe përvjetorin e festave të shumëfishta në Kosovë. Kjo për mua përveç që është një motiv i rëndësishëm, është edhe më shumë obligim që të vazhdoj të punoj gjithnjë me përkushtim në marrjen e detyrave dhe përgjegjësi, në raport të drejt me objektivat e FSK-së". Remzije Morina përveç që është një oficerë e zonja në Forcën e Sigurisë së Kosovës, ajo, po ashtu, ka treguar sukses edhe në ngritjen e saj akademike si magjistër e ekonomisë. Ka përfunduar studimet postdiplomike në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Ekonomik, drejtimi "Menaxhment dhe Informatikë", ku edhe e ka mbrojtur temën „Menaxhimi i burimeve njerëzore në FSK".

Jeta civile dhe ajo ushtarake dallojnë dukshëm për major Remzijen. "Jetën civile, pothuajse, e kam të ndarë krejtësisht nga jeta ushtarake. "Jam pjesë e përgjegjësi dhe obligimeve në familje, sepse dëshira për të sfiduar nuk më mungon, por mbështetja e familjes ka qenë për mua motiv dhe alternativë në jetën time".

Duke u bazuar në përvojën e saj që nga lufta e deri më sot, ajo ka kaluar shumë sfida dhe është përballur me shumë vështirësi, por njëkohësisht nuk i kanë munguar edhe sukseset, si ngritja kohë pas kohe në karrierë. Por që të gjitha këto ajo i ka arritur falë përkushtimit të madh, motivit të lart për realizimin e qëllimit të saj, mbështetjes së vazhdueshme të familjes si shtylla kryesore në jetë dhe po ashtu edhe të miqve e shoqërisë që nuk i kanë munguar asnjëherë.

Major Remzije Morina nuk ngurroi që për pjesëtarët të cilët tashmë janë pjesë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe ata të cilët dëshirojnë të jenë pjesë e saj të japë edhe një porosi. "Që të gjithë të jenë në shërbim të dijes, le të dëgjojnë atë lloj të „muzikës" e cila ndikon në zhvillimin e karakterit dhe personalitetit të tyre. Guximi dhe trimëria luajnë një rol shumë të rëndësishëm, varësisht se çfarë ata zgjedhin në shkollimin e mëtejshëm. Le të jenë model i vetive më të mira për gjeneratat e ardhshme, sepse edukimi dhe shkollimi i mirë japin edhe oficerë të mirë. Fundja, shkollimi është parametri me premtues i së ardhmes" përfundoi major Remzije Morina, oficerë për Plane dhe Programe të Buxhetit, në Departamentin e Financave në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Intervistë me toger Jeton Ahmeti, pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës

Oficeri i FSK-së, Qytetar Nderi i qytetit 'Huntsville-Alabama' të SHBA-ve

"Gjithçka që kam arritur deri me sot është meritë e QSU-së, mund të them se QSU ka qenë çelësi i të gjitha sukseseve të mia sado të vogla të cilat i kam pasur gjatë dhe pas diplomimit tim"

Toger Jeton Ahmeti është pjesëtar i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe punon si udhëheqës i Togut të Dytë, Kompanisë B të Batalionit të Tretë, në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë.

Shkollimi i tij në Qendrën për Studime Universitare (QSU) ka qenë bazamenti i suksesit dhe arritjeve e sfidave të cilat Ahmeti i ka kaluar që nga fillimi i tij si kadet e deri në promovimin e tij si toger i FSK-së. "Gjithçka që kam arritur deri me sot është meritë e QSU-së. Mund të them se QSU ka qenë çelësi i të gjitha sukseseve, sado të vogla, të cilat i kam pasur gjatë dhe pas diplomimit tim".

Jeton Ahmeti ishte shpallur edhe "Qytetar nderi" i qytetit Huntsville të Alabamës më datë 5 qershor 2010 dhe kjo për të ishte një satisfaksion, sepse jo çdo ditë mund të merrej një titull i tillë, e aq më tepër në një moshë të re siç ishte Jetoni. Në fakt ky çmim nuk iu shtua vetëm arkivit të kadet Ahmetit, i cili në atë kohë ende ishte kadet i QSU-së, por ky çmim iu shtua edhe FSK-së si njëra ndër sukseset e pjesëtarëve të saj.

"Për arsye të arritjeve akademike, fizike dhe të udhëheqësive ushtarake, si njeri ndër studentët më të dalluar gjatë trajnimit, në të njëjtën kohë asistent i instruktorëve amerikan për CCNA rrjeta kompjuterike, shefi i Zyrës për Studentë Ndërkombëtarë zotëri Walter R. Andrae, më ka propozuar për këtë çmim, i cili bën të ndihem shumë krenar, për të cilin iu detyrohem të gjithë të rënëve për lirinë e Kosovës, pa gjakun dhe sakrificën e të cilëve nuk do të isha këtu" thotë Ahmeti. Jeton Ahmeti ka përfunduar Shkencat Kompjuterike në Universitetin për Biznes dhe Teknologji (UBT), ku edhe aty gjatë studimeve ka qenë njëri ndër studentët më të dalluar, për këtë e dëshmon edhe sukcesi që kishte arritur në Kampionatin Evropian të Robotikës "Euroby 2008" në Linz të Austrisë në vitin 2008, ku kishte marr vendin e 3-të.

"Unë së bashku me Toger Faton Bekteshin gjithashtu pjesëtar i FSK-së, në ekipin e UBT-së ku koordinator ishte Prof. Dr. Artan Dermaku kemi pasur fatin ta prezantojmë Kosovën për herë të parë në garat evropiane të robotikës, ku në mesin e 16 ekipeve evropiane kemi zënë vendin e 3-të. Konkurrent kemi pasur prof. dr. të kompjuterikes, mirëpo me punën dhe mundin tonë

kemi arritur të radhitemi si ekipi i 3-të në Evropë". Po ashtu ai ka marr edhe Medaljen e Artë "German Proficiency Badge-GPB" ku ka tejkaluar standardet fizike të cilat janë paraparë në këtë garë të organizuar nga Zyra Ndërlidhëse gjermane në Fort Gordon, SHBA në vitin 2010.

Ka përfunduar trajnime dhe është certifikuar në fusha të ndryshme profesionale si kursi bazik për sinjale, siguria e të dhënave, rrjetet kompjuterike, të gjitha të përfunduara në Fort Gordon në SHBA gjatë vitit 2010. Trajnimin për Server 2008 R2, trajnimin për planifikim operacional, taktika për njësi të vogla etj. Është duke i vazhduar studimet master për Inxhinieri Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Për Jetonin është krenari që ka qenë vazhdimësi e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës pasi që tri vite ai i ka kaluar si kadet në TMK. Prej fillimit të punës si oficer në FSK, ka punuar dy vite si oficer i Planifikimit në G6, në Komandën e Forcave Tokësore, ndërsa tash është transferuar në Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Mitrovicë për ta sfiduar vetën edhe me trupa.

"Jam udhëheqës i Togut të Dytë, Kompanisë B në Batalionin e Tretë në BRSH. Detyra ime është plani-



fikimi, trajnimi, këshillimi dhe përgatitja e 30 pjesëtarëve që të jenë të gatshëm t'i përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë të cilat kërkohen prej tyre".

Ahmeti kishte pasur disa oferta për punë në fushën e kompjuterikes, por asnjëherë nga to nuk i kishte pranuar sepse uniforma e FSK-së është mburrje dhe krenari për të. "Puna me trupa është një ndjenjë e veçantë dhe të bënë të ndjehesh krenar çdo ditë e më shumë, madje në asnjë punë nuk besoj se do mund të jepja kontribut më të madh se në FSK" është shprehur Ahmeti. Po përveç përkushtimit të tij në punën që bën Jetoni është edhe prind i

përkushtuar. Ai është i martuar me pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) Hava Sekirana dhe kanë një djalë të quajtur Diell

"Në jetën civile i përkushtohem më shumë familjes dhe djalit të vogël Diellit tre muajsh, studimeve dhe ndonjëherë kur me jepet rasti udhëtimeve brenda dhe jashtë Kosovës, ndërsa në jetën ushtarake duhet të jem i përkushtuar kurdo që kërkohet prej meje, planifikimi, ushtrimet, trajnimet, këshillimet, të cilat janë vetëm disa nga elementet që e bëjnë më sfiduese jetën ushtarake, mirëpo edhe kjo ka anë e saj pozitive" përfundoi Jeton Ahmeti.

U certifikuan edhe 33 pjesëtarë të FSK-së në kursin "Lider Luftarak"



Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes, në Ferizaj, u bë certifikimi i 33 pjesëtarëve të FSK-së, të cilët kanë kryer kursin e lartë për lider luftarak. Në ceremoni morën pjesë, ministri i FSK-së Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, gjeneralmajor Rrahman Rama, zv.ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës zonj. Kelly Degnan, kolonel James Kott atashu ushtarak i SHBA-ve, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, Zymer Halimi dhe Nazmi Brahimaj, kolonelët; Eoicik, Blake Storey, Bondstel dhe oficerë e ushtarak të FSK-së dhe KFOR-it. Ministri i FSK-së Agim Çeku, ka përshëndet të pranishmit e sidomos Shtete e Bashkuara të Amerikës, për këtë që po bëjnë, në trajnimet, shkollimin dhe ngritjen profesionale të FSK-së. Ai tha: sot FSK-së, po i bashkohen edhe 33 pjesëtarë të diplomuar për Lider luftarak, ky është edhe një sukses i madh i FSK-së, në ngritjen e korit të liderit luftarak që është bazë kryesore e çdo ushtrie moderne. Certifikimin e sotëm e konsideroj një ngjarje të rëndësishme, për arsye se këta nënoficerë të përgatitur po i shtohen radhës së sukseseve të cilat FSK-ja ka arritur gjatë këtij viti. E rëndësishme është se FSK-ja i ka edhe 33 nënoficerë luftarak të përgatitur për misione që kërkohen. Ministri Çeku, nënoficerëve të certifikuar u tha: ju jeni udhëheqës të parë të ushtarëve, ushtarët presin nga ju detyra, ju jeni bartës kryesor të ushtrisë, ju do të përgatitni ushtarët në detyra luftarake. Ne jetojmë në paqe dhe do zoti të jetojmë gjatë në paqe, por një gjë duhet të mbani në mend dhe ta keni detyrë; të përgatiteni se një ditë do të sprovoheni në detyrat që ju keni mësuar dhe përgatitë nga ky trajnim. Dy gjëra që ju duhet të mbani në mend gjithherë, janë: Zbatimi i

detyrës dhe kujdesi ndaj ushtarëve tuaj. Në emër të ambasadores së SHBA-ve, Jacobson dhe Admiralit Stavridis, Komandantit të komandës Evropiane, nënoficerëve, me një fjalë përshëndetëse, ju drejtuat kolonel James Kott, atashu ushtarak i SHBA-ve, në Prishtinë, i cili fjalimin e lexoi në gjuhën shqipe. "Formimi i korpusit të nënoficerëve të trajnuar dhe të përgatitur mirë është një detyrë thelbësore e çdo ushtrie. Ne jemi shumë krenar, që Shtetet e Bashkuara kanë luajtur një rol të sigurojnë që sot FSK-ja të ketë 33 nënoficerë të trajnuar rishtazi, të cilët janë mirë të përgatitur për të udhëhequr dhe trajnuar skuadrat, togjet dhe kompanitë e tyre. Ne jemi gjithashtu krenarë se kursi ka përfshirë një pjesëmarrës nga partneri rajonal, Shqipëria. Unë gjithashtu dua të

theksojë se ky trajnim i vlefshëm është bërë i mundur nëpërmjet Fondit të SHBA-së për financimin e ushtrive mike, i koordinuar nga ekipi i Zyrës për bashkëpunim të Mbrojtjes. Dhe sigurisht që asgjë nga kjo nuk kishte me qenë e mundur pa inkurajimin, interesin dhe përfshirjen e liderit të FSK-së. Në fund kolonel Kott, tha se karakteri i nënoficerit dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës si një organizatë duhet ti ketë këto elemente daluese, të jetë: Udhëheqës, Kompetent dhe i Disiplinuar. Përgjegjësi kryesore e nënoficerit janë; realizimi i misionit dhe mirëqenia e ushtarëve të mi. Ndërsa, gjeneralbrigade Enver Cikaqi, komandant i KDS-së, tha: Ne po shënojmë edhe një sukses tjetër në lëmin e trajnimeve duke përfunduar këtë kurs, që është ndër kurset më të avancuara që kemi mbajtur deri më tani në KDS dhe në përgjithësi në FSK. Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes është duke vazhduar trajnimet bilaterale me Ushtrinë e SHBA-së, përmes programeve të edukimit dhe stërvitjeve për të zhvilluar dhe përgatitur udhëheqës për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Në fundu shpallën edhe kadetët më të mirë, të cilët u nderuan me mirënjohje, për arritjen e rezultateve gjatë kryerjes së kursit të lart, për Lider Luftarak.



FSK-ja në Paradën e 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë

Në paradën e 100 vjetorit të krijimit të Shtetit Shqiptar për herë të parë mori pjesë edhe një kuadrant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), në përbërje prej 65 pjesëtarëve, ku prej tyre 11 ishin femra. "Është një ndjesi shumë e mirë, është privilegj dhe nder të marrësh pjesë në

100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë. Për neve është një krenari shumë e madhe, mund të them krenaria më e madhe që unë kam përjetuar", është shprehur një prej anëtarëve të FSK-së. Kuadranti i FSK-së u tregua shumë i suksesshëm.



Orkestra Frymore e FSK-së dha një koncert festiv për Vitin e Ri

Me rastin e festave të fund vitit, Orkestra Frymore e FSK-së ka dhënë një koncert festiv. Në koncert morën pjesë, ministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati, komandanti i KFOR-it, ish-ministri i FSK-së Fehmi Mujota, ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipërisë Sylejman Selimi, oficerë të KFOR-it, të FSK-së, atashu ushtarak si dhe personalitete të tjera të jetës politike, artistike dhe kulturore. Në fjalën e tij, ministri Agim Çeku, pasi ka përshëndet mysafirët, falënderoi të gjithë ata që e kanë mbështet ngritjen e FSK-së, për të shtuar: "Është kënaqësi që jemi mbledhur sot këtu për ta fuqizua miqësinë dhe bashkëpunimin tonë, ta përcjellim së bashku këtë vit dhe të shikojmë me optimizëm drejt vitit të ardhshëm. Forca e Sigurisë së Kosovës është e përkushtuar të bëhet një forcë aktive dhe e dukshme, një institucion i përkryer i cili

do t'i shërbejë të gjithë qytetarëve dhe po kontribuon në ndërtimin e paqes dhe stabilitet në rajon dhe në botë. Edhe këtë vit ne kemi punuar shumë dhe kemi arritur një progres të dukshëm në shumë fusha. Ne e kemi thelluar partneritetin tonë bilateral dhe i kemi nënshkruar disa Marrëveshje Bashkëpunimi me shtetet tona partnere, kemi marr pjesë në iniciativa dhe ngjarje të rëndësishme të lidhura me çështjet e sigurisë, e kemi themeluar Qendrën e Ekselencës për Kërkim-Shpëtim nga e cila do të përfitojë i gjithë Rajoni, kemi kaluar Ligjin e pensioneve për FSK-në, jemi pajisur me uniforma te reja unike moderne dhe funksionale". Ministri Çeku foli edhe për besimin e madh që ka FSK-ja tek qytetarët e Kosovës. "Për mua është shumë i rëndësishëm fakti që FSK-ja është ndër institucionet më të besuara të Kosovës. Kjo ka një domethënie të madhe dhe na inspiron që të punojmë edhe më shumë për të mirën e vendit dhe popullit tonë". Për kultivimin e vlerave artistike dhe kulturore në FSK-së, ministri Çeku, tha: "Ne jemi vazhdimisht duke i kultivuar vlerat dhe traditat tona, por edhe identitetin tonë. Si pjesë e kësaj përpjekje kemi themeluar Orkestrën Frymore të Forcës së Sigurisë së Kosovës një Orkestër i cili aktualisht është i përbërë nga më shumë se 30 muzikantë të rinj, profesionistë të profesioneve të ndryshme, qoftë pjesë e Filarmonisë, qoftë profesorë, arsimtarë, mësimdhënës të edukatës muzikore që vullnetarisht janë lajmëruar të jenë pjesëtarë edhe të FSK-së".

Në fund, ministri Agim Çeku ua uroj të gjithëve Krishtlindjet dhe një Vit të Ri dhe të suksesshëm dhe njëherit kërkoi që bashkërisht ta përcjellin koncertin e parë të ekzekutuar nga Orkestra Frymore e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Pastaj, Orkestra Frymore e FSK-së, dha një koncert me vepra të famshme botërore dhe kombëtare. Këngët "Valsi i lumturisë", "Kënga për heroin e kombit tim", "Hej ju male", "Agimet Shqiptare", etj, ishin disa nga veprat artistike të interpretuara me sukses nga Orkestra Frymore e FSK-së. Interpretimi i këngëve ushtarake dhe klasikë, nën dirigjimin e Toger Baki Jasharit u përcoll me një interesim të madh dhe me duartrokitje të gjata e frenetike. Është synim i MFSK-së që Koncerti Festiv i Orkestrës Frymore të FSK-së, për çdo Vit të Ri, do të jetë tradicional.

FSK-ja përfitoi donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare

Forca e Sigurisë së Kosovës ka përfituar një donacion nga Zyra Civile Ndërkombëtare-ICO, donacion ky i cili ka vlerë të çmueshme për nevojat të FSK-së dhe njësisive të saj.

Ministri Agim Çeku e ka vlerësuar aktin e ICO-së me rastin e ndarjes së këtij donacioni për FSK-në, si edhe ka çmuar prioritetin e Zyrës Civile



Ndërkombëtare sipas së cilit, FSK-ja ka qenë përfituese e këtij donacioni. Ministri Çeku është shprehur se infrastruktura dhe pajisjet për FSK-

në, në vazhdimësi janë përparësi, kështu që përkrahja me donacione është e mirëseardhur dhe shumë e nevojshme. Ai ka falënderuar Zyrën Civile Ndërkombëtare për mbështetjen që i ka dhënë FSK-në me rastin e ndarjes së donacionit. Ndërsa, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Kadri Kastrati ka vlerësuar

lartë vlerën e donacionit e cila do të jetë në shërbim të Kompanisë së Deminimit Humanitar. Donacioni kap vlerën rreth 150 mijë euro, pajisje transporti. Gjithsej gjashtë automjete, prej tyre dy minibus dhe katër xhupa, si edhe pajisje të teknologjisë informative (pesëdhjetë kompjuterë).